



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 384, datë 30.6.2021

4377
2071

PËR

**FORMËN E KOMUNIKIMIT NË
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në procedurat e prokurimit "Dialog konkurrues", "Partneritet për inovacion", "Konkurruese me negociim" dhe "Konkurs projektimi", fazat vijuese, pas fazës së parakualifikimit, zhvillohen në formë shkresore.
2. Ngarkohen të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

¹ Ky projektvendim është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 "Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2014/18/KE", e ndryshuar, me numër CELEX 32014L0024, "Fletore zyrtare" e Bashkimit Evropian seria L, nr.94, datë 28.3.2014, faqe 65-242;
- Direktivën 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE", e ndryshuar, me numër CELEX 32014L0025, "Fletore zyrtare" e Bashkimit Evropian seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243-374.

NR.PROT.3179/1
DATË 2.7. 2021

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

